

UEFA/ 10 mije euro te tjera gjobe per Kuketin

nga AlbaniaSoccer

E premte, 06 Shtator 2013 20:38



Skudra e Kuketit ka marre edhe 10 mije euro te tjera gjobe per sjelljet antisportive te tifozeve ne ndeshjet e Europa Leagues. Pas gjobes se pare 27 mije euroshe, te marre te enjten, skudra e Kuketit ka marre nje tjetere fature te majme per te paguar. Verilindoret bene historine ne Europe gjate veres por tani duhet te paguajne nje shume te madhe gjobash per hedhje sendesh te forta dhe perdorjen e lazerave ndaj lojtareve kundertshtare. Per ndeshjen me Flora Talin, Kuketi ka marre 10 mije euro, ndersa per dy takimet e dyta, ndaj Sarajevos dhe Metalurgut 27 mije. Ne total jane 37 mije euro gjobe por Kuketi rrezikon me shume per ndeshjen me Trabzonsporin ku sjellja e tifozeve kuksian ishte e ekzagjeruar. Gjoba per kete takim nuk ka ardhur akoma.